



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2025

Nentor 2024



©Akademia e Drejtësisë 2024, Të gjitha të drejtat e rezervuara Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Plani i punës dhe i Performancës për vitin 2025 është miratuar nga Këshilli
Drejtues i Akademisë me datën 18.11.2024

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave	6
Hyrje	7
I. PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2024 DHE SFIDAT GJATË REALIZIMIT TË TIJ	8
2. Rëndësia e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2025.....	10
3. Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë.....	11
4. Organet e Akademisë së Drejtësisë.....	12
4.1 Këshilli Drejtues	12
4.2 Këshilli Programor.....	12
4.3 Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.....	12
II. OBJEKTIVAT E PERGJITHESHME TE PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2025.....	13
1. PËRGATITJA PROFESIONALE E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR.....	13
1.1 Zbatimin e trajnimit praktik 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI	14
1.2 Zbatimin e trajnimit fillestar për 31 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XII.....	15
1.3 Zbatimi i trajnimit fillestar për 24 prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e XI	15
1.4 Zbatimi i trajnimit fillestar për 21 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIII.....	16
1.5 Zbatimi i trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIV dhe 30 prokuror e sapo emëruar të gjeneratës së XII.....	16
1.6 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të Performancës.....	17
1.7 Zbatimi i trajnimit të trajnuesve.....	17
2. AVANCIMI I VAZHDUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE DHE INTERDISIPLINARE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONISTEVE TË TJERË LIGJOR.....	17
2.1 Zbatimi i trajnimeve që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike	19
2.2. Zbatimi i trajnimeve sipas prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe nevojave trajnuese te gjyqtareve dhe prokuroreve.....	21
2.3 Realizimi i trajnimeve përmes tryezave për adresimin e problemeve praktike dhe çështjeve nga praktika gjyqësore.....	21
2.4 Zbatimi i trajnimeve të përbashkëta me profesioneve te lira	22
2.6 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor si dhe	

për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	22
3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë	23
3.2 Ngritja e cilësisë së trajnimeve, monitorimi dhe analiza e të dhënave të performancës së trajnuesve për vitin 2025;.....	24
3.3 Hulumtimi dhe përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore	24
3.4 Avancimi i veprimtarisë botuese si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së	25
3.5 Zbatimi i masave dhe politikave euro integruese si dhe raportimi i rregullt në mekanizmat përkatës	25
3.6 Hartimi dhe zbatimi i monitorimit të Planit të Integritetit të AD-së për vitin 2025.....	26
4. AVANCIMI DHE ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT ME PARTNERËT VENDOR, DONATORËT DHE INSTITUCIONET TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE.....	26
4.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës	26
4.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare	27
5. NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE ADMINISTRATIVE, CILËSISË SË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIMEVE FINANCIARE TË BUXHETIT	27
5.3 Ngritja e cilësisë së shërbimeve të TI-së administrative dhe logjistike ..	29
6.1 Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së -2025	32
6. Sfidat dhe rreziqet	39
7. Përfundimi.....	39

Lista e shkurtesave

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

ABEK – Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

FMCS – Federal Mediation and Conciliation Service

ENM – Ecole Nationale de la Magistrature

EJTN – European Judicial Training Network

ERA - Academy of European Law

EULEX - European Union Rule of Law Mission

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

INL - Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OPDAT- Office of Overseas Prosecutorial Development

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

UNDP – United Nation Development Program

UNODC - United Nation Office on Drugs and Crime

Hyrje

Për zbatimin e programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera cilat janë në shërbim të përfituesve të AD-së sipas ligjit Ligjit nr. 05/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës_Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe Rregullores nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore, është përgatitur Plani i Punës dhe i Performancës së AD-së për vitin 2025.

Plani paraqet objektivat dhe veprimet konkrete në zbatim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara me ligj të cilat janë në përputhje me zhvillimet e reja duke u bazuar në kapacitetet dhe resurset në njësitë përkatëse që ka ky institucion si edhe përvojën dhe praktikat më të mira për realizimin e tyre.

Plani i Punës dhe i Performancës së AD-së për vitin 2025 është i fokusuar në aktivitetet të cilat janë në funksion të zbatimit të programeve trajnuese fillestare dhe të vazhdueshme si dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara me ligj. Objektive kryesore e këtij plani është aftësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj me funksionet përkatëse dhe zhvillimi profesional i gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë duke përfshirë profesionistëve tjerë ligjor në fushat të cilat janë identifikuar si mangësi me rastin e vlerësimit të nevojave trajnuese. Përmes këtij dokumenti janë përcaktuar njësitë përgjegjëse, veprimet që do të ndërmerren për realizimin e tyre duke përfshirë periudhën kohore si dhe treguesit apo indikatorët që do të mundësojnë matjen dhe monitorimin e përmbushjes së rezultateve.

Në përmbushje të Planit të punës dhe Performancës, AD ka përgatit planin e veprimit për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara i cili është pjesë e këtij dokumenti.

I. PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2024 DHE SFIDAT GJATË REALIZIMIT TË TIJ

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2024 është përmbushur në tërësi për këtë vit për të gjitha programet.

Në trajnimet fillestare gjatë vitit 2024 e kanë vijuar 3 gjenerata të gjyqtarëve të sapo emëruar (X, XI, dhe XII) dhe një e prokurorëve të sapo emëruar (X). Kjo dëshmon përkushtimin e Akademisë së Drejtësisë për të përmbushur nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përkatësisht kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së në përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj duke përcjellë zhvillimet dhe proceset e rekrutimit të një pas njëshme për këto pozita në të dy këshillat dhe duke marrë masat për hartimin e programeve si dhe zbatimin e tyre për tri grupet e gjyqtarëve dhe një grup të prokurorëve.

Pra, është vazhduar zbatimi i trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit për 28 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X. Paralel me grupin e gjyqtarëve edhe trajnimi teorik dhe praktik njëkohësisht për 22 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X me 2 (dy) ditë të trajnimit teorik nga modulet e këtij programi në Akademi të Drejtësisë dhe 3 (tre) ditë tjera të javës trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse të emërimit. Të dy gupet (i gjyqtarëve dhe i prokurorëve) kanë përfunduar trajnimin fillestar me 15 maj 2024 dhe për të dy këto profile është realizuar testi përfundimtar dhe janë përgatitur raportet me vlerësimet përfundimtare për KGJK dhe KPK.

Nga muaji shkurt i vitit 2024 ka filluar trajnimi fillestar edhe për 15 gjyqtarë të rinj të sapo emëruar që për AD-në përbëjnë gjeneratën e XI. Ky grup i gjyqtarëve ka përfunduar trajnimin teorik në muajin korrik dhe nga kjo periudhë kanë vijuar trajnimin praktik në gjykatat përkatëse të emërimit si dhe në institucionet tjera jashtë gjyqësore.

Krahas trajnimit praktik të 15 gjyqtarëve të lartpërmendur ka filluar së zbatuari nga muaji shtator 2024 trajnimi fillestar edhe për gjeneratën e XII, përkatësisht për 32 gjyqtarë të sapo emëruar. Ngjashëm me gjeneratat paraprake gjyqtarët me kërkesën e KGJK-së kanë vijuar sesionet e trajnimit teorik intenzivisht në 5 ditë të javës në AD për 4 muaj me radhë dhe do të vazhdojnë edhe për gjatë vitit 2025.

Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme deri tani aktualisht janë realizuar 103¹ aktivitete trajnuese për gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe për profesionistë tjerë ligjor,

¹ Numri prej 103 përfshijnë periudhën deri në fund të muajit shtator 2024

ndërkaq deri në fund vit edhe 31 aktivitete trajnuese.

Janë realizuar siç janë planifikuar trajnimet në fushën penale me theks në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, trajnimet për të drejtat e njeriut, për dhunën në familje, drejtësinë për fëmijë, drejtësinë civile, komerciale, administrative, trajnimet në fushën e ndërmjetësimit dhe trajnime tjera në të cilat kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë si dhe profesionistë tjerë ligjor.

Bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive përveç se kanë marrë pjesë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë kanë përfituar edhe nga trajnimet ekskluzivisht të dizajnuara për funksionet e tyre nga modulet e trajnimit bazik. Ngjashëm edhe profesionistët e tjerë ligjor dhe veçanërisht ndërmjetësuesit, avokatët shtetëror si dhe zyrtarët e ndihmës juridike falas.

Me kërkesën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë realizuar sesionet e trajnimit edhe për 15 gjyqtarët porotë të emëruar gjatë vitit 2023, të cilët nuk kanë arritur të jenë pjesë e trajnimit me grupin e parë që vijuan trajnimin menjëherë pas emërimit në Akademi të Drejtësisë. Sipas vendimit të KGJK-së trajnimi është realizuar duke ju përmbajtur kurrikulës së rekomanduar nga ky institucion me qëllim përgatitjen dhe aftësimin e tyre për detyrat dhe përgjegjësitë sipas legjislacionit në fuqi në çështjet familjare dhe procedurën kontestimore.

Në kuadrin e vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë është zhvilluar procesi konform planifikimit. Janë përfshirë gjithë akteret e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke i shteruar gjitha burimet e informacionit përfshirë edhe rekomandimet që dalin nga dokumentet strategjike të vendit. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti i cili ofron analizën e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2025, ecurinë e procesit, metodologjinë si dhe rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces. Në fushën e publikimeve janë realizuar botimet periodike, modulet trajnuese sipas planifikimit si dhe janë zhvilluar dhe në proces të finalizimit për publikim Vendimet e përzgjedhura dhe Përmbledhja e praktikës gjyqësore nga Gjykata Supreme.

Megjithëse buxheti i pamjaftueshëm, në sektorin e financave janë realizuar të gjitha pagesat me kohë për obligimet që kanë rrjedh gjatë këtij viti, dhe furnizimi me mallra dhe shërbime është realizuar konform planit vjetor të prokurimit.

Aktivitetet e ndërmarra në pjesën e fundit të vitit 2023 nga AD në zbatim të reformës së administratës publike, respektivisht në zbatim të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës janë përmblyllur me sukses në fillim të vitit 2024. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, ka

përfunduar procesin e ristrukturimit të secilit nëpunës civil të Akademisë së Drejtësisë. Në këtë kontekst në harmoni me përcaktimet e LZP-së, si dhe Ligjit për Paga në Sektorin Publik janë lëshuar aktet e reja të emërimit për të gjithë nëpunësit civil , si dhe gjate këtij viti janë zhvilluar gjithsej 14 procedura të rekrutimit, ku prej tyre 9 procedura kanë përfunduar me sukses, dhe 5 procedura kanë rezultuar pa kandidat fitues.

Për përmbushjen e këtyre aktiviteteve të lartpërmendura ka qenë sfiduese koordinimi i trajnuesve meqë vetëm në PTF ishin paralelisht nga dy gjenerata njëkohësisht dhe prej dy profileve pa përjashtuar edhe trajnimet e vazhdueshme me përfituesit e saj sipas ligjit. Krahas këtyre vështirësive edhe organizimi i trajnimeve shtesë si rezultat i kërkesave nga projektet me donatorë ka pasur sfidat e saj në sigurimin e pjesëmarrjes, dhe si dhe zbatimi i kriterëve sipas doracakut për trajnues dhe aspekte tjera. Me gjithë këto, duke ju falënderuar angazhimit dhe mbështetjes së partnerëve të saj është arritur përmbushja e planit dhe performancës për vitin 2024.

Ndërsa, sa i përket administratës dhe shërbimeve të përgjithshme, sfiduese ka vazhduar të jete buxheti i pamjaftueshëm, mungese në investime kapitale, si dhe zbatimi i legjislacionit të ri dhe procedurave në SIMBNJ për zyrtarët publik, respektivisht sigurimi i buxhetit për 4 pozitave të reja sikurse të parapara me Rregulloren nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD.

1. Vizioni dhe misioni

Akademia e Drejtësisë është institucion shtetëror i edukimit dhe aftësimit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, faktor kyq për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që duhet të gëzojë besimin e publikut.

Akademia e Drejtësisë ofron trajnime cilësore për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, harton analiza, zhvillon hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe standardet e mira ndërkombëtare.

2. Rëndësia e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2025

Hartimi i Planit të Punës dhe i Performancës është kërkesë ligjore e nenit 3 dhe 4 i Ligjit nr. 05/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe Rregullores nr. 3/2020 për performancën e agjencive. Prandaj duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, Akademia e Drejtësisë ka hartuar Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2025.

Rëndësia e këtij plani konsiston në atë se orienton për një vit punën e Akademisë së Drejtësisë, përkatësisht departamenteve dhe divizioneve që veprojnë në kuadër të saj duke përcaktuar proceset që duhet zhvilluar dhe hapat e mëtutjeshëm deri në arritjen e rezultateve. Gjithashtu është instrument thelbësor përmes të cilit përcaktohet edhe kuadri brenda institucionit të cilët duhet të angazhohen në aktivitetet përkatëse.

Për përmbushjen në tërësi të këtij plani, AD do të angazhohet në menaxhimin e punës, bashkërendimin e aktiviteteve në mes programeve, bashkërendimin e shërbimeve tjera që i ofron sipas ligjit, koordinimin dhe bashkëpunimin me KGJK, KPK, Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët e Prokurorive, koordinimin dhe bashkëpunimin me trajnuesit dhe partnerët zhvillimor dhe mbështetës të AD-së në mënyrë që përfituesit e saj sipas ligjit të ngritin kapacitetet profesionale dhe interdisiplinare dhe të performojnë më mirë në punën e tyre.

3. Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L -095 për AD-në, si dhe me plotësim Ligjit nr. 08/L-063, kapitulli IV për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, Akademia themelohet si institucion publik i pavarur e cila si funksion kryesor ka ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira përmes zbatimit të trajnimeve dhe zhvillimit të veprimtarisë botuese dhe materialeve tjera ligjore.

Vija llogaridhënëse sipas *Ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura* është te Këshilli Drejtues i saj. Përveç legjislacionit bazë janë edhe aktet nënligjore të rishikuar gjatë vitit 2023 si në vijim:

- Rregullorja Nr. 01/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 02/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 03/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 04/2023 - Për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr.5/2023 Për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë

Projektligji për AD-në është në proces të ndryshimit dhe plotësimit. Si i tillë përkundër agjendës legjislative nuk ka kaluar ende në kuvend për shqyrtim dhe miratim. Plani i Punës dhe i Performancës është hartuar mbi bazën aktuale ligjore dhe për çdo ndryshim eventual që rrjedhë nga hyrja në fuqi e ligjit të ri që ka efekt edhe në Planin e Punës dhe të Performancës do të rishikohet dhe do të përditësohet përshtatshëm.

4. Organet e Akademisë së Drejtësisë

4.1 Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues si organ më i lartë i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2025 do të fokusohet në shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve si në vijim:

- Raporti vjetor i punës dhe i Performances për vitin 2024
- Listën e trajnuesve të përkohshëm
- Listën e mentorëve
- Udhëzuesin për hulumtime dhe botime të AD-së
- Projekt buxhetin e AD-së
- Formimin e komisioneve që dalin sipas nevojës për funksionimin më të mirë të AD-së;
- Kërkesat e KGK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që janë në proces të rekrutimit;
- Programin Fillestar për gjyqtarë të sapo emëruar
- Programin për trajnime të vazhdueshme për vitin 2026
- Planin e Punës dhe të Performancës për vitin 2026 si dhe çështje tjera që dalin sipas zhvillimeve gjatë vitit 2025.

4.2 Këshilli Programor

Këshilli Programor si organ profesional do të angazhohet për të siguruar cilësi për programet trajnuese dhe trajnimet e ofruara dhe aktivitetet si në vijim:

- Shqyrtimin e listës së trajnuesve dhe mentorëve dhe mendim për listën e trajnuesve potencial për Këshillin Drejtues;
- Sigurimin e kualitetit të programeve trajnuese në PTF dhe PTV përmes orientimit të metodave dhe teknikave trajnuese;
- Përcjellë e realizimin e programeve dhe suksesin e tyre si dhe
- Hartimin e programit trajnues për vitin 2026

4.3 Drejtori Ekzekutiv i Akademisë

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë do të angazhohet në prioritet si në vijim:

- Përfaqësimin e Akademisë në institucione vendore dhe ndërkombëtare;
- Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- Do të siguroj zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues
- Do të propozoj projektbuxhetin vjetor të Akademisë;
- Do të propozoj Planin e punës dhe të Performancës si dhe Programin trajnues të Akademisë për vitin 2026
- Do të propozoj listën e trajnuesve për miratim nga Këshilli Drejtues dhe nga lista do të caktoj trajnuesit për zbatim të programit;
- Do të Menaxhoj me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë dhe aktivitete tjera sipas mandatit.

II. OBJEKTIVAT E PERGJITHESHME TE PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2025

1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionisteve të tjerë ligjor;
3. Zhvillimi i programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese;
4. Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët vendor, donatorët dhe institucionet trajnuese ndërkombëtare;
5. Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit

1. PËRGATITJA PROFESIONALE E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR

Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2025 pasi të dy këshillat (KGJK dhe KPK) kanë rekrutuar grupe të reja të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët sipas ligjit kanë obligim ligjor trajnimin fillestar. Bazuar në programin dhe kalendarin trajnues për 15 gjyqtarët të gjeneratës së XI do të vazhdojë zbatimi i trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit deri në muajin mars 2025. Gjatë kësaj periudhe gjyqtarët do të asistojnë në aktivitetet gjyqësore të mbikëqyrur nga mentorët e tyre gjyqtarë, të cilët në baza javore do të informojnë Akademinë e Drejtësisë për ecurinë dhe zhvillimet gjatë trajnimit praktik. Në përfundim të trajnimit praktik gjyqtarët do të nënshtrohen testit përfundimtar.

Krahas kësaj gjenerate, AD do të vazhdojë zbatimin e trajnimit fillestar edhe për gjeneratën e XII të gjyqtarëve, përkatësisht 32 gjyqtarë fillestar. Për këtë gjeneratë trajnimi fillimisht teorik ka filluar në shtator të vitit 2024 dhe do të vazhdojë edhe për gjatë vitit 2025, përkatësisht deri në muajin shkurt me

modulet në çështje civile. Me këto sesione do të përmbillet pjesa e trajnimit teorik për të vazhduar më pas me trajnimin praktik në gjykatat përkatëse të emërimit.

Në trajnimin fillestar priten edhe gjenerata e XI e prokurorëve, përkatësisht 24 prokurorë pasi është përfunduar procesi i rekrutimit nga KPK dhe tashmë janë në fazën e dekretimit.

Krahas kësaj gjenerate të prokurorëve priten edhe 21 gjyqtarë të rinj pasi aktualisht gjenden në procedurat e rekrutimit nga KGJK. Për këtë gjeneratë do të hartohet programi përshtatshëmrisht me kërkesat e KGJK dhe sistemin gjyqësor në përgjithësi dhe do të zbatohet programi sipas legjislacionit në fuqi.

Andaj, Programi i Trajnimit Fillestar për vitin 2025, do të fokusohet në objektivat specifike si në vijim:

- 1.1 Zbatimin e trajnimit praktik për 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë;
- 1.2 Zbatimin e trajnimit fillestar duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik për 32 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI;
- 1.3 Zbatimin i trajnimit fillestar për 24 prokurorët e gjeneratës së XI
- 1.4 Zbatimin i trajnimit fillestar duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik për 21 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës e XIII;
- 1.5 Zbatimi i trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata e XIV dhe për 30 prokurorët e sapo emëruar gjenerata e XII si dhe
- 1.6 Zbatimin e trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarë dhe prokurorë me performancë të pa mjaftueshme
- 1.7 Zbatimi i trajnimit të trajnuesve

1.1 Zbatimin e trajnimit praktik 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI

Trajnimi fillestar për 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI i filluar në shkurt të vitit 2024 do të vazhdojë edhe për tre muaj e parë të vitit 2025. Gjatë kësaj periudhe do të realizohen sesionet e fundit të trajnimit praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorëve. Mentorët në baza javore do të mbajnë të informuar Akademinë e Drejtësisë për zhvillimet dhe rezultatet e trajnimit praktik.

Bazuar në strukturën dhe kalendarin e këtij programi pas përfundimit të trajnimit praktik në përputhje me legjislacionin në fuqi do të realizohet testi përfundimtar me rezultatet e të cilit përmbillet programi fillestar për këtë gjeneratë. Paneli për hartimin dhe vlerësimin e provimit përfundimtarë do të angazhohet në hartimin dhe vlerësimin e provimit, ndërkaq stafi përgjegjës i këtij programi do të angazhohet në përmbledhjen e vlerësimeve për detyrat dhe angazhimet tjera

të gjyqtarëve gjatë trajnimit fillestar dhe në përgatitjen e raportit përfundimtar për gjyqtarët e kësaj gjenerate që do të dërgohet në KGJK, përkatësisht për Komisionin e Vlerësimit të Performancës.

1.2 Zbatimin e trajnimit fillestar për 31 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XII

Trajnimi fillestar për 32 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XII i filluar me 6 shtator 2024 do të vazhdojë edhe më tej deri në muajin tetor të vitit 2025. Tashmë janë vetëm 31 gjyqtarë meqë një prej tyre nga komuniteti serb do të vazhdojë me gjeneratën e radhës për shkak të pushimit të lehonisë. Gjatë kësaj periudhe do të vazhdojnë trajnimet nga modulet civile deri në shkurt dhe më pas trajnimi praktik në gjykatat përkatëse të emërimit deri në tetor 2025.

Mentorët e gjyqtarëve do të zbatojnë mentorimin e gjyqtarëve gjatë trajnimit praktik dhe Akademinë e Drejtësisë në baza javore do ta mbajnë të informuar për rezultatet e trajnimit praktik. Në kuadrin e trajnimit praktik, gjyqtarët e sapo emëruar do të vijojnë edhe trajnime në institucione jashtë gjyqësore.

Sipas strukturës së këtij programi pas përfundimit të sesioneve të trajnimit teorik dhe praktik do të realizohet provimi përfundimtar me rezultatet e të cilit përmbillet programi fillestar edhe për këtë gjeneratë të gjyqtarëve. Ngjashëm si për gjeneratat paraprake Paneli për hartim dhe vlerësimin e provimit përfundimtarë do të angazhohen në hartimin dhe vlerësimin e provimit dhe stafi përgjegjës i këtij programi do të angazhohet në përmbledhjen e vlerësimeve për detyrat dhe angazhimet tjera të gjyqtarëve gjatë trajnimit fillestar dhe në përgatitjen e raportit përfundimtar për çdo njërin prej tyre për KGJK-në, përkatësisht për Komisionin e Vlerësimit të Performancës.

1.3 Zbatimi i trajnimit fillestar për 24 prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e XI

Akademia e Drejtësisë konform mandatit të saj ka përcjellë zhvillimet në sistemin prokurorial lidhur me rekrutimin e prokurorëve të rinj i cili është realizuar përmes konkursit të hapur dhe publik në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2024. Nga ky proces pritet të dekretohen prokurorët të cilët e kanë kaluar me sukses këtë proces meqë kanë përfunduar gjitha fazat e rekrutimit. Konkursi ka qenë për 28 pozita të lira, prej tyre 4 nga komuniteti jo shumicë. Ky grup i prokurorëve të rinj për Akademinë e Drejtësisë përbëjnë gjeneratën e XI në trajnimin fillestar andaj janë ndërmarrë gjitha masat për të përmbush mandatin e saj me ligj përmes koordinimit ndërinstucional dhe punës së përbashkët me KPK dhe Këshillin Programor të AD-së si në hartimin e programit trajnues ashtu edhe për zbatimin e trajnimit fillestar për këtë gjeneratë.

Modulet të cilat i dedikohen prokurorëve të sapo emëruar janë përditësuar me

çështjet ligjore relevante për prokurorët fillestar dhe janë si në vijim:

- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese

Trajnimi pritet të filloj së zbatuari menjëherë pas dekretimit dhe do të vazhdojë me zbatimin e trajnimit teorik dhe praktik paralelisht për një periudhe prej 12 muajsh. Trajnuesit që do të angazhohen në zbatim të trajnimeve fillestare do të përzgjidhen nga lista e trajnuesve të AD-së.

1.4 Zbatimi i trajnimit fillestar për 21 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIII

Këshilli Gjyqësor i Kosovës gjatë vitit 2024 ka zhvilluar dy procese të rekrutimit, fillimisht me grupin prej 32 gjyqtarëve që tashmë janë në program fillestar, ndërsa në fund vit edhe për një grup të ri prej 21 gjyqtarëve të rinj. Akademia e Drejtësisë është duke përcjellë procesin e rekrutimit të gjyqtarëve të rinj dhe në hap me këto zhvillime do të angazhohet së bashku me KGJK-në dhe Këshillin Programor të saj në hartimin/përditësimin e programit fillestar në përputhje me ndryshimet e reja legjislative. Programi për këtë gjeneratë do të përmbajë trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, duke përfshirë edhe Acuis Communautaire, KEDNJ dhe aktet e tjera ndërkombëtare si dhe kompetencën interdisciplinare.

Modulet që janë pjesë e programit për gjyqtarët fillestar do të përditësohen me çështje ligjore relevante për gjyqtarët fillestar dhe janë si në vijim:

- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- E drejta civile administrative dhe ekonomike
- Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese

Trajnimi do të filloj së zbatuari menjëherë pas dekretimit fillimisht me modulet e lartpërmendura në Akademi të Drejtësisë për gjashtë muaj me radhë. Modulet e trajnimit janë gërshtim i trajnimit teorik i përcjellë edhe me raste praktike dhe simulime dhe më pas me trajnimin praktik në gjykata për një periudhe prej gjashtë muajsh që rezulton 12 muaj gjithsejtë.

1.5 Zbatimi i trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIV dhe 30 prokuror e sapo emëruar të gjeneratës së XII

Akademia e Drejtësisë përveç planifikimit për gjeneratat e lartëpërmendura në planin e punës ka paraparë edhe trajnimet fillestare për gjenerata tjera, përkatësisht gjenerata e XII e prokurorëve dhe gjenerata e XIV e gjyqtarëve meqë sipas zhvillimeve në KGJK dhe KPK parashihen edhe rekrutime të reja.

1.6 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të Performancës

Akademia e Drejtësisë do të jetë e gatshme të angazhohet në realizimin e trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarë dhe prokuror me performancë të pamjaftueshme varësisht nga kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së. Lidhur me këtë nëse do të ketë kërkesa të tilla do të angazhohet me të dy këshillat për të hartuar programet trajnuese në modulet që do të përcaktohen nga të dy këshillat dhe do të angazhojë trajnues me përvojë në zbatim të trajnimeve konform kriterëve të përcaktuar për këto lloj të trajnimeve.

1.7 Zbatimi i trajnimit të trajnuesve

Metodologjia trajnuese do të vazhdojë të jetë prioritet edhe për vitin 2025. Veçanërisht përmes sigurimit të zbatimit të Doracakut për trajnues i hartuar së fundmi për metodologjinë trajnuese, i cili kërkon teknika të mësuarit për të rritur dhe gjithashtu një angazhim më të madhe të trajnuesit para dhe pas trajnimit. Shtuar kriterëve të përcaktuara në doracak, trajnuesit konform kërkesave të trajnimeve fillestare do të obligohen që trajnimet ti zbatojnë përmes analizës dhe studimit të rasteve dhe në disa module edhe në simulim të rasteve gjyqësore. Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme do të realizohen trajnime dhe tryeza për unifikim të praktikës gjyqësore nga trajnues me përvojë dhe të certifikuar sipas programit të AD-së për trajnues.

Gjithashtu do të vazhdojë programi i trajnimit të trajnuesve të rinj të cilët janë në listën e trajnuesve të përzgjedhur gjatë vitit 2024. Numri i sesioneve dhe kohëzgjatja e TIT do të përcaktohet varësisht nga përmbajtja që do të kenë trajnimet përkatëse.

2. AVANCIMI I VAZHDUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE DHE INTERDISIPLINARE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONISTEVE TË TJERË LIGJOR

Rritja dhe avancimi i kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistë tjerë ligjor është thelbësore për të pasur një sistem gjyqësor efikas dhe të drejtë. Pas çdo vlerësimi të nevojave trajnuese rezulton nevoja për përmirësimin në zbatimin e drejtë të legjislacionit

në fuqi për një mori kompetencash të punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor relevant për proceset gjyqësore. Përveç kësaj është kërkesë e vazhdueshme edhe raporteve qoftë vendore ashtu edhe ndërkombëtare, organizatave që monitorojnë sundimin e ligjit në Kosovë dhe veçanërisht Strategjisë për sundimin e ligjit 2021-2026 edhe një varg dokumentesh tjera strategjike në nivel nacional të cilat AD-në e bëjnë përgjegjëse ose mbështetëse të KGJK-së dhe KPK-së.

Duke iu referuar programit të trajnimit të vazhdueshëm janë gjithësejt të përfshira 133 aktivitete me kohëzgjatje prej 169 ditë trajnimi. Prej tyre 83 aktivitete trajnuese me kohëzgjatje prej 118 ditë trajnimi për gjyqtarë e prokurorë që përfshijnë çështje penale veçanërisht për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit, formave tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, dhunës në familje, aspektin e të drejtave të njeriut, për çështjet administrative veçanërisht për konfliktin administrativ me që pritet të hyjë në fuqi ligji i ri në janar 2025, çështjet civile veçanërisht për procedurat gjyqësore në çështje kontestimore dhe jo kontestimore, në drejtësinë për fëmijë, në drejtësinë komerciale dhe çështjet tjera që janë sfiduese të praktikës gjyqësore. Këshilli Programor si organ profesional ka hartuar programin trajnues duke i përcaktuar përfituesit, kohëzgjatjen dhe metodologjinë për secilën prej tyre që pritet bashkë me këtë plan të miratohet nga Këshilli Drejtues.

Ndërsa do të vazhdohet sikurse vitin e kaluar ofrimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional duke përfshirë edhe stafin e ri të rekrutuar që janë 35 aktivitete trajnuese me 35 ditë trajnimi . Gjithashtu edhe 15 aktivitete trajnuese me 16 ditë trajnimi për stafin tjetër mbështetës të gjykatave dhe prokurorive të ri dhe atyre me përvojë të cilat do të dizajnohen sipas detyrave të punës, përvojës si dhe kompetencave specifike që ka secili prej tyre në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Vëmendje të veçantë do të kenë edhe profesionistët e tjerë ligjor, veçanërisht ndërmjetësuesit, përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe jo vetëm të cilët do të përfshihen në aktivitete të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithashtu edhe dy trajnime për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive.

Andaj, trajnimet e vazhdueshme për vitin 2025, do të fokusohen në objektivat specifike si në vijim:

- 2.1 Zbatimi i trajnimeve që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike;
- 2.2 Zbatimin e trajnimit sipas prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe sipas nevojave trajnuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- 2.3 Zbatimin e tryezave për unifikim të praktikës gjyqësore
- 2.4 Zbatimi i trajnimeve të përbashkëta me profesioneve të lira
- 2.5 Zbatimin e trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive

- 2.6 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor si dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
- 2.7 Zbatimin e trajnimeve përmes platformave të mësimin në distancë sipas kërkesave.

2.1 Zbatimi i trajnimeve që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike

Strategjia për sundimin e ligjit 2021-2026, përkatësisht Plani i Veprimit për vitin 2024-2026 përcakton një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve dhe trajnimeve që duhet të përfshihen në Planin e punës dhe të performancës së AD-së. Ato janë mandatore për programin trajnues të AD-së prandaj si të tilla do të jenë prioritet për AD-në dhe do të vazhdohet sipas ecurisë dhe planit të përcaktuar për secilën prej tyre. Sipas strategjisë janë **33 masa/aktivitete** prej të cilave të përmbledhura janë si në vijim:

- Ofrimi i trajnimeve të specializuara për menaxhim dhe udhëheqje për kryetarët e gjykatave, kryeprokurorëve, gjyqtarët mbikëqyrës dhe kandidatët në pozita drejtuese;
- Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial i kryer në 3-5 vitet e fundit.
- Trajnimi i gjyqtarëve dhe stafit mbështetës në fusha të specializuara komerciale.
- Ofrimi i trajnimeve të specializuara për gjyqtarë në fushat e identifikuara si mangësi gjatë vlerësimit të performancës.
- Realizimi i një analize mbi nevojën për specializim të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KGJK dhe KPK në bashkëpunim me AD-në
- Rishikimi i programit të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor;
- Zgjerim i Platformës Elektronike të AD, për të përmbajtur më shumë module të trajnimeve online;
- Ofrimi i trajnimeve për të gjithë anëtarët e Komisionit të rekrutimit për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Trajnime për njësinë e verifikimit të KGJK-së me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në verifikim.;
- Trajnime të specializuara për prokurorët dhe gjyqtarët, si dhe hetuesit në njësinë për hetimin e krimeve të luftës, lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës;
- Zhvillimi i programit të ri trajnues për gjyqtarët dhe prokurorët për drejtësinë për të mitur për t'u përshtatur me ndryshimet e fundit ligjore;
- Organizmi i trajnimit për gjyqtarët lidhur me trajtimin e rasteve nga lëmia civile (shkurorëzimi, alimentacioni, fëmijët pa kujdes prindëror dhe adoptimi);
- Trajnimet për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit;

- Trajnim për gjyqtarët dhe ndërmjetësuesit lidhur me unifikimin e praktikave të pranimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit dhe trajnime ne fushën civile, familjare dhe pronësore
- Hartimi i kurrikulës dhe ofrimi trajnimeve bazike dhe të specializuara për gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale
- Trajnim për zyrtarët e ANJF-së lidhur me paraqitjen e padive konform dispozitave të LPK-së dhe Kodit të ardhshëm të Procedurës Civile;
- Përgatitja e kurrikulës së trajnimit për Ligjin e ri për Konfliktet Administrative dhe organizimi i trajnimeve për gjyqtaret, zyrtaret e ANJF, avokatet shtetëror,
- Trajtime për procedurat e falimentimit

Për këto masa periudha kohore e realizimit është deri në vitin 2026, andaj Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në zbatimin e aktiviteteve trajnuese në të cilat është institucion përgjegjës ndërkaq në ato masa që është institucion mbështetës i KGJK-së, KPK-së ose institucioneve tjera të drejtësisë pret nga këto institucione meqë varet edhe nga gatishmëria e institucioneve përkatëse.

Disa nga aktivitetet sipas kësaj strategjie në të cilat AD është institucion mbështetës me theks te trajnimet dedikuar komisioneve, organeve, veprimtaria e të cilëve është vlerësimi i performancës, verifikimi e çështje tjera që janë pjesë e punës së KGJK-së dhe KPK-së mbeten të gjenden mundësi të realizimit përmes ekspertizës së jashtme pasi AD nuk ka pasur përvojë në këtë drejtim.

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut- po ashtu kërkon e rritjen e profesionalizmit dhe kompetencës së gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me fokus në lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjalizimin e gazetarëve në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës. Sipas këtij programi janë **6 masa/aktivitete** prej të cilave të përmbledhura janë si në vijim:

- Trajnimin për procedurën penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore
- Trajnimin për rastet e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe ngacmimit seksual me një qasje të përqendruar nga viktimat
- Trajnimi për mos diskriminimin
- Trajnimi për praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut
- Trajnimi për Lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjalizimin e gazetarëve në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës;
- Trajnimi për ndarjen e pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit, alimentacioni, mbajtja financiare e bashkëshortit-es.

Një pjesë e konsiderueshme e këtyre aktiviteteve do të realizohet përmes mbështetjes së donatorëve, veçanërisht përmes projekteve të Këshillit të Evropës.

Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 gjithashtu kërkon rritjen e profesionalizmit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe përveç kësaj edhe në rastet kur përfshihen kryes me çrregullime mendore. Andaj, Plani i Punës dhe i Performancës së AD-së do të ketë prioritet realizimin e trajnimeve në këtë fushë. Bazuar në kërkesat që dalin nga ky dokument strategjik, 7 sesione trajnuese duhet të realizohen për dhunën në familje (aspekti penal dhe civil) si dhe 2 sesione trajnuese për rastet kur në procedurë përfshihen kryesit me çrregullime mendore. Në sajë të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës, përmes Projektit “Përafrimi i legjislacionit me Konventën e Stambollit” është rishikuar kurrikula e trajnimit dhe mbi bazën e kësaj edhe modulet trajnuese.

2.2. Zbatimi i trajnimeve sipas prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe nevojave trajnuese të gjyqtareve dhe prokurorëve

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë përkushtimin e saj në përmbushjen e kërkesave dhe prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së. Në radhë të parë në zbatimin e trajnimeve të detyrueshme që janë rezultat i obligimeve ligjore dhe akteve nën ligjore të KGJK-së dhe KPK-së nëse do të ketë kërkesa nga të dy institucionet. Në zbatimin e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë sipas propozimeve në programin trajnues 2025 si dhe në zbatimin e trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor që është kërkesë ekskluzive nga KGJK. Bazuar në kërkesën e KGJK-se aktivitetet trajnuese për gjyqtarë do të realizohen në metodologjinë e kërkuar përmes tryezave të diskutimit si forma më të përshtatshme për adresimin e sfidave dhe problemeve praktike në gjyqësor.

Trajnimet do të dizajnohen me target gjyqtarët dhe prokurorët kompetent dhe do të realizohen përmes metodologjisë së studimit të rasteve dhe metodave tjera trajnimit gjyqësor.

2.3 Realizimi i trajnimeve përmes tryezave për adresimin e problemeve praktike dhe çështjeve nga praktika gjyqësore

Tryezat për unifikim të praktikës gjyqësore vazhdojnë të jenë të kërkueshme edhe për vitin 2025 si një nga format më të përshtatshme për të ngritur dhe avancuar njohuritë e gjyqtareve dhe prokurorëve në fusha dhe tema të caktuara. Andaj, në kuadër të këtij plani janë përfshirë tryezat (penale, civile, administrative) që janë 6 gjithësejt dhe një mori aktivitetesh tjera që do të trajtohen në këtë formë përmes të cilave do të adresohen problemet praktike nga panelistë prej radhës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të nivelit të Apelit dhe Suprem. Produkt i këtyre tryezave do të jenë konkluzionet për unifikimin e praktikës ose eventualisht sipas dinamikës hartimi i doracakëve, udhëzuesve ose

formave tjera të cilat do të vazhdojnë të publikohen dhe të jenë të qasshme për zbatuesit e ligjit.

2.4 Zbatimi i trajnimeve të përbashkëta me profesioneve te lira

Si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit me odat e profesioneve të lira dhe kërkesave nga dokumentet strategjike, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave trajnuese të përbashkëta. Veçanërisht me mbrojtësit e viktimave, ndërmjetësuesit e licencuar nga MD, avokatët shtetëror, përmbauesit, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe profesionistë tjerë ligjor puna e të cilëve lidhet me punën e gjykatave dhe prokurorive.

2.5 Zbatimin e trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive

Rritja e kapaciteteve menaxheriale për pozitat udhëheqëse në gjykata dhe prokurori është nevojë e vazhdueshme e cila është identifikuar në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe gjithashtu edhe kërkesë e Strategjisë për sundimin e Ligjit dhe mekanizmave tjerë integruar. Në funksion të kësaj AD do të angazhohet në zbatimin e këtij trajnimi duke iu mundësuar menaxhmentit të gjykatave dhe prokurorive shkathësitë veçanërisht në planifikimin, organizimin dhe mbarëvajtjen e punës në gjykata dhe prokurori për funksionimin më të mirë të institucioneve përkatëse. Zbatimi i këtij trajnimi do të mbetet prioritet edhe më tej për të krijuar një program të qëndrueshëm duke përfshirë edhe ngritje e kapaciteteve trajnuese në këtë fushë për vitin 2025

2.6 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor si dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë me zbatimin e trajnimeve sipas moduleve të trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të cilët nuk kanë vijuar këto trajnime. Fokusi thelbësor do të jetë në përfshirjen e gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në gjykata dhe prokurori edhe trajnimet te tjera sipas kërkesave dhe nevojave të parashtruara në AD.

Siç e kërkon Strategjia për sundimin e Ligjit, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të Gjykatës Komerciale do të përfitojnë edhe nga trajnimet dedikuar gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale.

Stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial po ashtu do të kenë mundësinë e ndjekjes së moduleve të dizajnuara sipas detyrave të punës. Bazuar në Programin trajnues për vitin 2025, Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në zbatimin e trajnimeve sipas moduleve që përfshijnë aspektin profesional dhe interdisiplinar.

2.7 Zbatimi i trajnimeve për përmes platformës në distancë

Kurset e mësimit në distancë vazhdojnë të jenë në dispozicion për gjithë ata që nuk kanë mundësi pjesëmarrje fizike në trajnimet e AD-së. Që nga viti 2023 ne bashkëpunim me sekretariatit e platformes HELP te Këshillit të Evropës, janë zhvilluar dhe përshtatur 22 kurse të trajnimit , që kryesisht janë në fushën e të drejtave të njeriut në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, qasjes së grave në drejtësi si dhe arsytimit dhe shkrimit ligjor. Këto kurse trajnuese do të aktivizohen nëse ka kërkesa për trajnime nga përfituesit e saj sipas ligjit.

3. ZHVILLIMI I PROGRAMEVE TRAJNUESE, NGRITJA E CILËSISË SE TRAJNIMEVE, HULUMTIMEVE DHE VEPRIMTARISË BOTUESE

Ngritja dhe avancimi i cilësisë së trajnimeve varet nga cilësia e programeve trajnuese, përgatitja dhe përvoja trajnuesve si dhe aplikimi i metodologjive të avancuara në ofrim të trajnimeve. Gjithashtu, analizat dhe hulumtimet janë pjesë përbërëse dhe instrumenti thelbësor për zhvillimin e programeve trajnuese adekuata me nevojat trajnuese dhe përmirësimin e cilësisë së programeve. Përveç kësaj edhe krijimin dhe zhvillimin e botimeve të reja në fushën juridike me theks të përmbledhjet e praktikës gjyqësore, doracakëve, udhëzuesve dhe format tjera që lehtësojnë punën praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve si përfitues kryesor sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Në këtë vështrim Programi për hulumtime, botime dhe trajnues për vitin 2025 do të orientohet në këto objektiva specifike:

- 3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2026;
- 3.2 Ngritja e cilësisë së trajnimeve, monitorimi dhe analiza e të dhënave të performancës së trajnuesve për vitin 2025;
- 3.3 Hulumtimi dhe përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe publikimi i tyre;
- 3.4 Zhvillimin e botimeve të reja si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së si dhe
- 3.5 Zbatimi i masave dhe politikave euro integruese si dhe raportimi i rregullt në mekanizmat përkatës.
- 3.6 Zbatimi i monitorimit të Planit të Integritetit të AD-së

3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë

Komponentë e rëndësishme e punës së Divizionit për Hulumtime, Botime dhe Trajnues është vlerësimi i nevojave trajnuese. Do të vazhdojë përgjatë gjithë vitit përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave nga mekanizmat e AD-së me qëllim që programi trajnues i radhës të adresoj problemet e praktikës gjyqësore.

Të gjitha resurset brenda kësaj njësie do të angazhohen në analiza dhe hulumtime, në mbledhje të burimeve dhe informacioneve dhe në pajtim me strategjitë dhe prioritetet e gjyqësorit do të ofrohen në takimet dhe punëtoritë e përbashkëta me krerët kryesor të gjykatave dhe prokurorive dhe për Këshillin Programor të AD-së për zhvillim të mëtejshëm.

3.2 Ngritja e cilësisë së trajnimeve, monitorimi dhe analiza e të dhënave të performancës së trajnuesve për vitin 2025;

Ngritja dhe avancimi i metodologjia trajnuese do të vazhdojë të jetë prioritet edhe për vitin 2025. Veçanërisht përmes sigurimit të zbatimit të metodologjisë së trajnimit sikurse e përmbledhur në Doracakun për trajnuesit hartuar së fundmi për metodologjinë e avancuar trajnuese, i cila kërkon teknika të mësuarit për të rritur dhe gjithashtu një angazhim më të madhe të trajnuesit para dhe pas trajnimit. Shtuar kriteret të përcaktuara në doracak, trajnuesit konform kërkesave të trajnimeve fillestare do të obligohen që trajnimet të zbatohen përmes analizës dhe studimit të rasteve dhe në disa module edhe në simulim të rasteve gjyqësore. Metodologjia e tillë tashmë është pjesë përbërëse e Programit të Trajnimit Fillestar, ku numri i konsiderueshëm i sesioneve të trajnimit përmes simulimit praktik të rasteve janë shtuar. Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme do të realizohen trajnime dhe tryeza për unifikim të praktikës gjyqësore nga trajnues me përvojë dhe të certifikuar sipas programit të AD-së për trajnues.

Gjithashtu do të vazhdojë programi i trajnimit të trajnuesve të rinj sipas metodologjisë së avancuar në Doracak të cilët janë në listën e trajnuesve të përzgjedhur gjatë vitit 2024. Numri i sesioneve dhe kohëzgjatja e TIT do të përcaktohet varësisht nga përmbajtja që do të kenë trajnimet përkatëse.

Monitorimi i performancës së trajnuesve ka për synim ngritjen e cilësisë së ofrimit të trajnimeve, dhe si e tillë konform legjislacionin dhe politikave të AD-së trajnuesit e angazhuar gjatë çdo viti do të nënshtrohen vlerësimit të performancës nga Këshilli Programor dhe Këshilli Drejtues. Andaj në pajtim me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore të AD-së, Doracakut për trajnues, ky proces do të monitorohet përmes mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave përmes anketave vlerësuese, ku do të krijohen dosjet e trajnuesve dhe raportet përkatëse për shqyrtim të performancës së trajnuesve nga Këshilli Programor dhe Këshilli Drejtues.

3.3 Hulumtimi dhe përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore

Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme tryezat për gjyqtarë dhe prokurorë do të rezultojnë me konkluzione për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe krahas kësaj edhe për Akademinë e Drejtësisë. Për të realizuar përmbledhjet do të nevojitet bashkërendimi me PTV-në, trajnuesit dhe panelistët e aktiviteteve

përkatëse të cilët në diskutimet e përbashkëta gjatë tryezave dhe aktiviteteve tjera dalin me konkluzionet e përbashkëta të cilat do të shërbejnë si udhërrëfyes për praktikën gjyqësore unike. Programi i PHP-së do të kujdeset për publikimin e tre dhe sigurimin e qasjes për përfituesit.

3.4 Avancimi i veprimtarisë botuese si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së

Do të vazhdojë angazhimi dhe bashkëpunimi me Gjykatën Supreme dhe KGJK-në për zhvillimin e përmbledhjeve të praktikës gjyqësore të cilat tashmë janë tradicionale për ditët e gjyqësorit çdo vit. Në këtë kontekst ofrimi i mbështetjes praktike për autorët e përmbledhjes në përcaktimin e çështjeve ligjore që do të jenë në kuadër të përmbledhjes dhe aspekte tjera me rëndësi në këtë fushë sa i përket përgatitjes për shtyp.

Aktivitet në vazhdimësi do jetë zhvillimi, përgatitja dhe botimi i moduleve trajnuese si të përcaktuara në programet trajnuese në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara me doracakun për trajnues.

Buletini informativ do të publikohet në baza periodike përmes mbledhjes dhe editimit të raporteve nga aktivitetet e realizuara.

Biblioteka elektronike AD-së me resurset e saj do të vazhdojë të jetë në funksion të përfituesve të saj dhe sipas nevojës edhe asistencë për qasjen e tyre sipas kërkesave. AD do të vazhdojë anëtarësimin në ABEK dhe me këtë rrjedhimisht pagesën vjetore, një shumë simbolike për të siguruar qasje në databaza të ndryshme ndërkombëtare që ky konzorcium i ofron për vendet në zhvillim.

3.5 Zbatimi i masave dhe politikave euro integruese si dhe raportimi i rregullt në mekanizmat përkatës

Akademia e Drejtësisë edhe për vitin 2025 do të vazhdojë në zbatimin e masave dhe politikave integruese. Në këtë drejtim Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në zbatimin e rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare që monitorojnë sistemin e drejtësisë. Vëmendje të veçantë do të kenë analiza e te gjeturave dhe rekomandimeve nga raporti të KE-së për Kosovën me theks në rritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe formave tjera të korrupsionit. Gjithashtu do të vazhdojë të monitorojë dhe raportojë të dhëna sipas indikatorëve në baza të rregullta dhe rrjedhimisht në përmbushjen e agjendës evropiane.

Gjithashtu analiza dhe përmbledhja e të dhënave nga vlerësimi i nevojave trajnuese janë përfshirë dhe pasqyruar në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme për vitin 2025. Te gjitha rekomandimet e dala nga dokumentet strategjike janë inkorporuar, e posaçërisht prioriteti i ju është dhënë obligimeve që dalin nga Strategjia e sundimit të ligjit, strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje, programi kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rekomandimet nga mekanizmat e agjendës për reforma evropiane (ERA), PKZMSA. Ndaj

gjithë këtyre mekanizmave do të hartohen raporte mbi zbatueshmërinë e tyre në baza periodike dhe sipas kërkesave të mekanizmave përkatës.

3.6 Hartimi dhe zbatimi i monitorimit të Planit të Integritetit të AD-së për vitin 2025

Bazuar në nenin 25 të Ligjit nr. 08/L-017 të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është hartuar Plani i Integritetit për vitin 2024-2026 i AD-së në përputhje me kërkesat e Metodologjisë dhe udhëzimeve të nxjerra dhe të miratuara nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Ky Plan në konsultë me njësitë brenda AD-së do të rishikohet për vitin 2025 dhe do të përditësohet me masa eventualisht të reja sipas zhvillimeve dhe në baza të rregullta do të raportohet në Agjencinë për parandalim të Korrupsionit.

4. AVANCIMI DHE ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT ME PARTNERËT VENDOR, DONATORËT DHE INSTITUCIONET TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE

Në drejtim të avancimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, dhe me institucione trajnuese ndërkombëtare, Akademia e Drejtësisë do të orientohet në këto objektiva specifike:

- 4.1 Bashkëpunimin dhe koordinimin maksimal me KGJK, KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës;
- 4.2 Bashkëpunimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare;

4.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

Në funksion të zbatimit më të mirë të programeve trajnuese, Akademia e Drejtësisë do të bashkëpunojë shumë ngushtë me KGJK dhe KPK veçanërisht për aktivitetet e mbetura që dalin si rezultat i Strategjisë për sundimin e Ligjit dhe për trajnime shtesë nëse do të ketë si rezultat i vlerësimit të performancës. Me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive do të vazhdojë koordinimi për trajnimet sipas aplikimit, gjithashtu edhe me administratorët për zbatimin e trajnimeve bazike për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithashtu ky bashkëpunim do të fokusohet edhe në zhvillimin e kurrikulave trajnuese sipas nevojave dhe kërkesave të këtyre institucioneve dhe në shkëmbimin e informatave dhe çështjeve tjera në interes të përbashkët.

4.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare

AD do të vazhdojë bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë përmes përfaqësimit të saj në grupet punuese në fushën e legjislacionit dhe politikave për sundimin e ligjit, në përgatitje të inputeve për zbatueshmërinë e strategjive dhe aktivitetet tjera që janë interes i përbashkët. Vëmendje të veçantë do të kenë edhe institucionet tjera të sistemit të drejtësisë me të cilat AD ka arritur marrëveshje bashkëpunimi e për të cilat do të ftohen të bëhen pjesë e programit trajnues varësisht prej çështjeve që janë me interes dhe që janë fushëveprim i tyre.

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë përkushtimin e saj në projekte të përbashkëta ndërkombëtare edhe për gjatë vitit 2025. Në funksion të kësaj do të jetë pjesë e nismave të ndryshme rajonale e më gjerë veçanërisht në fushat specifike të cilat kanë mision kryesor zhvillimin e praktikave më të mira për ndërtimin e një gjyqësori profesional. Akademia do të mundësojë trajnuesve dhe veçanërisht përfituesve të saj pjesëmarrjen në trajnime, forume, konferenca dhe punëtori të ndryshme në institucione të trajnimit gjyqësor në nivel rajonal si dhe në organizata tjera të cilat kanë në fokus avancimin e trajnimit gjyqësor si dhe sundimin e ligjit.

Gjatë vitit 2025, duke u nisur nga bashkëpunimet e gjertanishme AD planifikon që një pjesë të konsiderueshme të trajnimeve të realizojë në mbështetje dhe bashkëpunim me partneret dhe projektet e ndryshme ndërkombëtare. Mbështetja dhe bashkëpunimi do të vazhdohet me organizatat dhe institucionet si në vijim: OPDAT, USAID /Drejtësia Komerciale, INL, FMCS, KE/Projektet e Këshillit të Evropës, OSBE, EULEX, BE/Projektet e BE, ENM , AIR Centre, EJTN, ERA, UNDP, GIZ, UNODC, HUMANITARIAN LAW CENTER KOSOVO, etj, si dhe bashkëpunimi e organizatat e shoqërisë civile.

Prioritet do të jenë edhe mundësimi i pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në programet trajnuese të EJTN-it dhe ERA, si dhe në programet për shkëmbim në institucionet trajnuese rajonale.

5. NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE ADMINISTRATIVE, CILËSISË SË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIMEVE FINANCIARE TË BUXHETIT

Procesi i riorganizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës, ka krijuar mundësinë AD-së që të fokusohet në masë të madhe në ngritjen e kapaciteteve

profesionale në kryerjen e detyrave dhe funksioneve si të përcaktuar në legjislacionin e zyrtareve publik. Struktura e re e brendshme organizative është e ndare në dy departamente dhe 8 divizione, që me kompetence do të sigurojnë zbatimin efikas të planit të punës dhe performances. Prioritet e strukturës së re organizative të AD do jete përmbushja e detyrave me kompetencë, profesionalizëm dhe me efektivitet. Funksionimi efektiv i proceseve të punës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve do të varet nga ndërveprimi dhe mbikëqyrja e departamenteve dhe njësive tjera organizative. Andaj, në planin e punës dhe performances janë identifikuar objektivat si ne vijim:

- 5.1 Transparenca dhe marrëdhënia me publikun
- 5.2 Avancimi i kapaciteteve profesionale administrative dhe zbatimi i rregullores për organizim të brendshëm
- 5.3 Ngritja e cilësisë së shërbimeve të TI-së administrative dhe logjistike
- 5.4 Menaxhimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i resurseve financiare
- 5.5 Ngritja e cilësisë së furnizimeve me mallra dhe shërbime dhe menaxhimi efektiv i kontratave

5.1 Transparenca dhe marrëdhënia me publikun

Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në transparencën dhe marrëdhënien me publikun përmes publikimit të gjitha aktiviteteve të saj, dokumenteve periodike si Planet e Punës dhe të Performancës, Raporteve vjetore dhe veçanërisht me vendimet e KD-së si organ drejtues i saj.

Do të vazhdojë përfshirja e shoqërisë civile në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe perspektiva e saj për programet trajnuese të AD-së. Ofrimi i të dhënave me aktivitetet e AD-së për gjitha grupet e interesit dhe përditësimi me të dhëna i webfaqes saj dhe platforma e rrjeteve sociale me zhvillimet e reja qoftë për punën e organeve të saj drejtuese ashtu edhe aktivitetet trajnuese përmes njoftimeve publike, shpalljeve dhe formave tjera.

5.2 Avancimi i kapaciteteve profesionale administrative dhe zbatimi i rregullores për organizim të brendshëm

Zbatimi dhe përmbyllja e procesit të kërkesave të dala nga reforma e administratës publike, respektivisht zbatimi i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, kanë mundësuar AD të themelojë departamente dhe divizione të reja me kompetence dhe vija llogaridhënëse të ndryshme nga ajo çfarë ka qenë më parë që synojnë ngritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit në pozitave përkatëse. Me miratimin e Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës nga Këshilli Drejtues në fund të vitit 2023 janë parapare 36 pozita, përkundër që vetëm 32 janë të lejuara dhe parapare me ligjin për buxhetin, ndërkaq dhe 4

pozita pritet të përfshihen me ligjin për buxhetin e vitit 2025. Nga 36 pozitat për personel si të parapare me Rregulloren për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizim, 1 pozitë është e nivelit të lart drejtues, 2 pozita nivel te mesëm drejtues, 8 pozita nivel i ulët drejtues dhe 25 nivel profesional. Plotësimi i pozitave të lira dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit konform sistematizimit dhe kompetencave synohet të rriten kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave si të përcaktuara në legjislacionin për zyrtaret publik. Në këtë kontekst në harmoni me përcaktimet në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, njësia e personelit të AD-së gjate këtij viti ka zhvilluar gjithsej 14 procedura të rekrutimit, ku prej tyre 9 procedura kanë përfunduar me sukses dhe 5 procedura kanë rezultuar pa kandidat fitues. Andaj në vazhdim të këtij procesi është hartuar planifikimi i rekrutimit për 5 pozitat e lira në AD për vitin 2025, si dhe për 4 pozitat shtesë që pritet të lejohen me ligjin për ndarjet buxhetore.

Ngritja e kapaciteteve profesionale do të fokusohet në trajnimet për stafin duke u fokusuar në legjislacion e administratës publike, menaxhim të kontratave dhe kompetencës profesionale.

5.3 Ngritja e cilësisë së shërbimeve të TI-së administrative dhe logjistike

Shërbimet e përgjithshme sipas kompetencës ligjore do mbështesin realizmin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në fushën e trajnimeve, në veprimtarinë hulumtuese dhe botuese dhe aktiviteteve tjera që janë fushëveprim i AD-së. Vëmendja dhe prioritet i TI do të jetë mbështetja në zbatim të programeve trajnuese, respektivisht realizmi i trajnimeve përmes platformës së mësimin në distancë.

Prioritet do të jetë menaxhimi dhe administrimi i dokumenteve, mirëmbajtja e sallave me paisjet e nevojshme të TI-së për zbatimin e trajnimeve, mirëmbajtja harduerit dhe sistemeve softuerike, menaxhimi dhe mirëmbajtja e inventarit dhe infrastrukturës së AD-së shërbimet e transportit, furnizimet për nevojat e AD-së dhe shërbime tjera që hyjnë në kuadrin e Departamentit për shërbime ligjore dhe të përgjithshme.

Divizioni për teknologji informative do të fokusohet edhe në automatizimin e proceseve të punës për programet trajnuese përmes sistemit të menaxhimit të aktiviteteve trajnuese, mundësimin e testeve online dhe aplikimeve për trajnime online, shkëmbimin dhe ndërlidhjen e të dhënave me KGJK dhe KPK dhe procese tjera që lehtësojnë veprimtarinë e AD-së.

5.4 Ngritja e cilësisë së furnizimeve me mallra dhe shërbime dhe menaxhimi efektiv i kontratave

Megjithëse buxheti i pamjaftueshëm, një pjese e konsiderueshme e buxhetit planifikohet të shpenzohet në mallra dhe shërbime. Te gjitha furnizimet me mallra dhe shërbime realizohet nga OE të cilët zgjedhën përmes procedurave të prokurimit në AQP. Andaj bazuar në kornizën ligjore në fuqi për prokurimin, aktivitetet e prokurimit edhe lidhja e kontratave për Akademinë e Drejtësisë është nën autoritetin e AQP-së pasi ka më pak se 50 staf të punësuar. Sidoqoftë, Akademia angazhohet në përgatitjet sa i përket specifikave për kontratat dhe planet për menaxhimin e kontratave, dërgon anëtarë të komisioneve për vlerësim të ofertave sipas kërkesës së AQP-së, cakton menaxher të kontratave dhe bënë menaxhimin e kontratave duke përgatit planet e menaxhimit dhe zbatimin e tyre në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2025, Akademia do të vazhdojë zbatimin e 20 kontratave për furnizime dhe shërbime të cilat i ka ende në shfrytëzim prej të cilave janë furnizime me naftë për vetura, ngrohje dhe gjenerator, furnizim me materiale të ndryshme për zyre, furnizim me pije për kafiteri, furnizim me ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në AD, furnizime me inventar, shërbime të telefonisë fikse dhe mobile, shërbime të fotokopjimit dhe printimit, shërbime të servisimit të veturave, shërbime të pastrimit të objektit dhe shërbime të sigurimit fizik të objektit. Gjithashtu planifikon të zhvilloj 9 aktivitete të prokurimit për furnizime dhe shërbime për shërbimet dhe furnizimet aktuale të cilat përfundojnë në vitin 2025.

5.5 Menaxhimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i resurseve financiare

Buxheti i Republikës së Kosovës është burim kryesor financiar i Akademisë së Drejtësisë. Pjesë shtesë e këtij buxheti janë edhe donacionet e ndryshme dhe mbështetja nga partneret ndërkombëtarë të cilët ndihmojnë Akademinë e Drejtësisë në aktivitetet e saj dhe në përmbushjen e mandatit të përcaktuar me ligj.

Divizioni për Buxhet dhe Financa do të angazhohet në përgatitjen e kërkesave buxhetore duke vlerësuar koston sipas programeve trajnuese, numrin e trajnuesve të angazhuar në zbatim të trajnimeve qoftë fillestare ashtu edhe të vazhdueshme, numrin e përfituesve dhe aktivitetet tjera sipas ligjit të AD-së.

Për vitin 2025, në qarkoren buxhetore është paraparë buxheti në total prej **842,137.00** euro, përkundër që kërkesa buxhetore e AD-së ka qenë **1,262,173.00**. Realizmi i aktiviteteve trajnuese të planifikuara në kuadër të PTF-së dhe PTV-së me buxhetin e aprovuar do jete shumë i vështirë pa ndihmën e partnerëve dhe donacioneve të tyre.

Akademia e Drejtësisë konform mandatit të saj ligjore është e obliguar të për të përmbushë kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së, Gjykatave, Prokurorive si dhe aktiviteteve tjera trajnuese që dalin nga strategjitë dhe prioritet tjera që ndërlihen me procesin euro-integrujes Kosovës. Përgatitja dhe avancimi i

aftësimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj me funksionet dhe kompetencën përkatëse mbetet prioritet e lart . Të dy këshillat kanë zhvilluar procese të reja të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj të cilët priten të vijnë trajnimet fillestare që sipas ligjit janë obligative, prandaj edhe mjetet buxhetore duhet të orientohen në këtë program që do të konsumojnë shumën më të madhe të buxhetit, respektivisht 339,503.00 euro vetëm nga mallrat dhe shërbimet. Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme janë një mori aktivitete të cilat janë obligative sipas dokumenteve strategjike për gjyqësorin dhe nga mekanizmat tjerë integruar që përveç për gjyqtarë dhe prokurorë kërkohet rritje e kapaciteteve profesionale edhe e bashkëpunësorëve profesional dhe stafit tjetër mbështetës në gjykata dhe prokurori duke përfshirë edhe profesioneve të lira. Këto kërkesa dhe aktivitetet tjera sipas programeve trajnuese do të rrisin shpenzimet me mallra dhe shërbime sikurse e përkthimi si simultant ashtu edhe përkthimi i moduleve të trajnimit dhe dokumenteve tjera, shërbimet e pastrimit, ngrohjes dhe furnizimeve tjera. Një pjese e madhe e trajnimeve të vazhdueshme planifikohet të realizohet përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes së projekteve dhe organizatave ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025 planifikohet që realizimi i buxhetit të ekzekutohet në përqindjen maksimale. Sfiduese mbetet zhvillimi i veprimtarisë së AD-në në objektin me qira përkundër që Akademia e Drejtësisë tashmë ka ndërtesën e ndarë por që ende nuk është në funksion për shkak të ngecjeve në ndërtim, përgjegjësi kjo e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Si rezultat i kësaj, rreth 8% e buxhetit shpenzohet për pagesën e qirasë gjë që e cenon përmbushjen e plotë të objektivave të përcaktuara në këtë Plan..

Planifikimit buxhetor do të paraprijnë takimet dhe vlerësimet brenda njësisë organizative të cilat luajnë rol të rëndësishëm në këtë proces. Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet duke respektuar rregullat ligjore në fuqi, të cilat sigurojnë realizimin e planit dhe programit të Akademisë.

6. Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së

Në Planin e veprimit si me poshtë janë të paraqitura objektivat e përgjithshme të cilat janë në përputhje me nevojat reale si të paraqitura në Planin e Punës dhe të Performancës. Objektivat janë reale dhe të realizueshme, dhe një pjese e madhe e aktiviteteve do të realizohen në bashkëpunim si të konfirmuar nga partneret mbështetës. Mbështetja dhe bashkëpunimi i AD-së me akteret e përfshirë në bashkëpunime do të fokusohet në ekspertizën e nevojshme , mbështetjen financiare dhe logjistike.

6.1 Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së -2025

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
1.Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar si dhe ngritja e shkathtësive trajnuese	Zbatimi i trajnimit praktik për 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë	Divizioni për trajnime fillestare	Janar – Mars	343,149 .00	BKK sa është buxheti	Raporti përfundimtar i hartuar për 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI të trajnuar në modulet sipas Programit trajnues 2024-2025.
	Zbatimi i trajnimit fillestar duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik për 32 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XII;	Divizioni për trajnime fillestare	Janar – Tetor		Raporti përfundimtar i hartuar për 32 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XII të trajnuar në modulet sipas Programit trajnues 2024-2025.	
	Zbatimi i trajnimeve fillestare për 24 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së XI	Divizioni për trajnime fillestare	Janar-Dhjetor		24 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së XI të trajnuar për institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe jashtë gjyqësore	
	Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për 21 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIII	Divizioni për trajnime fillestare	Janar-Dhjetor		21 Gjyqtarët e sapo emëruar të trajnuar në modulet përkatëse sipas programit trajnues për gjeneratën e XIII	
	Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIV dhe për 30 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së XII	Divizioni për trajnime fillestare	Shtator - Dhjetor		30 Gjyqtarët e sapo emëruar dhe 30 prokurorët të trajnuar në modulet përkatëse sipas programit trajnues për gjeneratën e XIV dhe XII	
	Zhvillimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të performances	Divizioni për trajnime fillestare	Janar-Dhjetor		Gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar në modulet sipas indikatorëve të performancës ²	
	Zbatimi i trajnimeve për trajnues	Divizioni për trajnime Fillestare	Janar-Dhjetor		Tri trajnime të trajnuesve të realizuara në mbështetje të donatorëve	
Trajnimet nga lëmia Penale	Divizioni për trajnime të	Janar-Dhjetor	119.000		23 trajnime, me pjesëmarrje rreth 575 pjesëmarrës. Prej tyre 300 nga	

² Zbatimi i trajnimit të detyrueshem varet nga kerkesat e KGJK-se dhe KPK-se

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor		vazhdueshme				radhët e gjyqtarëve, 190 nga radhët e prokurorëve si dhe 85 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional.
	Trajnimet nga lëmia Civile	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			9 trajnime me pjesëmarrje rreth 210 nga radhët e gjyqtarëve dhe rreth 60 bashkëpunëtorë profesional.
	Trajnimet nga lëmia e drejtësisë për fëmijë	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			5 trajnime me pjesëmarrje rreth 125. Prej tyre 55 nga radhët e gjyqtarëve, 35 nga radhët e prokurorëve si dhe 35 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarëve sprovues, zyrtarëve policor.
	Trajnimet për mbrojtjen nga dhuna në familje	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			4 trajnime me pjesëmarrje rreth 100. Prej tyre 50 nga radhët e gjyqtarëve, 25 nga radhët e prokurorëve si dhe 25 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional, mbrojtësve të viktimave si dhe zyrtarë tjerë ligjor.
	Trajnimet nga lëmia Komerciale	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			12 trajnime me pjesëmarrje rreth 130. Prej tyre 90 nga radhët e gjyqtarëve dhe 40 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional,
	Trajnimet nga drejtësia kushtetuese, administrative kundërvajtëse	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			9 trajnime me pjesëmarrje 120 pjesëmarrës. Prej tyre 90 nga radhët e gjyqtarëve dhe 30 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional
	Trajnimet për KEDNJ	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			5 trajnime me pjesëmarrje me rreth 115. Prej tyre 60 nga radhët e gjyqtarëve 30 nga radhët e prokurorëve dhe 25 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional dhe avokatëve shtetëror.
	Trajnimet nga e Drejta e BE-së	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			2 trajnime me pjesëmarrje rreth 50. Prej tyre 30 nga radhët e gjyqtarëve, 15 nga radhët e prokurorëve dhe 5 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional.

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
	Trajnimet nga kompetenca interdisciplinare	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			5 trajnime me pjesëmarrje rreth 125. Prej tyre 50 nga radhët e gjyqtarëve, 40 nga radhët e prokurorëve dhe 35 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional
	Trajnimet nga ndërmjetësimi	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			6 trajnime me pjesëmarrje rreth 150. Prej tyre 60 nga radhët e gjyqtarëve, 30 nga radhët e prokurorëve dhe 40 ndërmjetësues si dhe 20 nga radhët e zyrtarëve në gjykata që merren me ndërmjetësimin.
	Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			2 trajnime me pjesëmarrje rreth 40. Prej tyre 20 nga gjykatat dhe 20 nga prokuroritë.
	Zbatimi i trajnimeve të obligueshme sipas rregullores së KGJK dhe KPK	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			Gjyqtarë dhe Prokurorë të trajnuar për trajnimet e obligueshme ³
	Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			35 trajnime me rreth 1000 pjesëmarrës nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive
	Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			25 trajnime me rreth 700 pjesëmarrës nga radhët e administratorëve, referentëve, sekretarëve juridike, zyrtarëve për menaxhimin e lëndëve të gjykatave dhe prokurorive
	Ofrimi dhe zbatimi i trajnimeve sipas kërkesave të institucioneve të profesioneve të lira	Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Janar-Dhjetor			Përmbarues privat, mbrojtës të viktimave, zyrtarë të ANJF si dhe zyrtarë të OJQ-ve që ofrojnë ndihmë juridike falas të trajnuar në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë

³ Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajnuar varet nga kërkesat e KGJK dhe KPK.

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
						dhe prokurorë si dhe 5 trajnime të realizuara veçanërisht për profesionet e lira.
	Zbatimin e trajnimeve përmes platformave të mësimin në distancë sipas kërkesave.	Divizioni për trajnime të vazhdueshme dhe Divizioni për TI	Janar-Dhjetor			Sipas kërkesës gjyqtare e prokurore të trajnuar në kurset online
3.Zhvillimi i programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese	Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2026;	Trajnuesit & Divizioni fillestar, i vazhdueshëm dhe divizioni për hulumtime, botime dhe trajnues	Janar -Tetor			Raporti me analizën dhe vlerësimin e nevojave trajnuese i hartuar
	Ngritja e cilësisë së trajnimeve, monitorimi dhe analiza e të dhënave të performancës së trajnuesve për vitin 2025;	Divizioni për hulumtime, botime dhe trajnues	Janar -Nëntor			Raporti me vlerësimin e performancës së trajnuesve për vitin 2025 i hartuar
	Hulumtimi dhe përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe publikimi i tyre;	Divizioni për trajnime të vazhdueshme dhe Divizioni për hulumtime, botime dhe trajnues	Janar-Nëntor		17.800	Përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe publikimi i tyre

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
	Zhvillimin e botimeve të reja si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së si dhe	Divizioni për hulumtime, botime dhe trajnues	Janar-Nëntor			Realizimi dhe publikimi i buletineve në baza periodike, moduleve dhe përmbledhjeve të praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme
	Zbatimi i masave dhe politikave euro integruese si dhe raportimi i rregullt në mekanizmat përkatës	Divizioni për hulumtime, botime dhe trajnues	Janar-Dhjetor			Raportet periodike të hartuara dhe në dispozicion për Strategjinë për Sundimin e ligjit; Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje; Programin kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; PKZMSA & Agjendën Evropiane ; Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën dhe mekanizmat tjerë integruar
	Zbatimi i monitorimit të Planit të Integritetit të AD-së	Divizioni për hulumtime, botime dhe trajnues	Qershor-Dhjetor			Raporti për gjashtëmuajt dhe vjetor i hartuar dhe dërguar në Agjencinë për Luftim dhe Parandalim të Korrupsionit
Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
4. Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët vendor, donatorët dhe institucionet trajnuese ndërkombëtare	Bashkëpunimin dhe koordinimin maksimal me KGJK, KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës	Departamenti i Programit të Trajnimeve dhe Departamenti për shërbime ligjore dhe të Përgjithshme	Janar-dhjetor			Punëtoritë e përbashkëta Kurrikulat trajnuese të hartuara bashkë me institucionet dhe subjektet përkatëse dhe të miratuara
	Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare	Departamenti i Programit të Trajnimeve dhe Departamenti për shërbime ligjore dhe të Përgjithshme	Janar -Dhjetor			Pjesëmarrja dhe kontributi i rregullt i AD-së në grupet dhe formacionet e ndryshme për funksionimin më të mirë të sistemit të drejtësisë Gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar në institucione të trajnimit gjyqësor në rajon

Objekti i përgjithshëm	Nën objekti	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
5.Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit	Transparenca dhe marëdhënia me publikun	Divizioni për shërbime ligjore dhe bashkëpunim ndërinstytucional				Ofrimi i qasjes për palët e interesit Rreth 21 postime në linkedin, 84 në facebook si dhe në njoftimet dhe raportet në web sipas aktiviteteve të planifikuara qoftë në Programin trajnues ashtu edhe në aktivitete tjera në funksion të procesit të punës në AD
	Avancimi i kapaciteteve profesionale administrative dhe zbatimi i rregullores për organizim të brendshëm	Departamenti i Programit te Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme, Njësia e Burimeve Njerëzore	Janar-Dhjetor			Plani i rekrutimit dhe plani i trajnimit te stafit i hartuar dhe i zbatuar
	Ngritja e cilësisë së shërbimeve të TI-së administrative dhe logjistike	Divizioni për teknologji informative	Janar-Dhjetor			Raporti i vlerësimit te nevojave për pajisje dhe mirëmbajtje te TI Lista e pajisjeve funksionale dhe sistemet e automatizuara për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese
	Menaxhimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i resurseve financiare	Departamenti i Programit te Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme, dhe Divizioni për buxhet dhe financa	Janar-Dhjetor			Vlerësimi i nevojave për buxhet dhe Kërkesa buxhetore në bazë të numrit të aktiviteteve trajnuese të planifikuara e hartuar dhe e aprovuar nga KD Raporti i ekzekutimit te buxhetit
	Ngritja e cilësisë se furnizimeve me mallra dhe shërbime dhe menaxhimi efektiv i kontratave	Departamenti i Programit te Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore	Janar-Dhjetor			Raporti i vlerësimit te nevojave për mallra dhe shërbime Plani vjetore i prokurimit hartuar dhe raporti i zbatimit

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
		dhe te Përgjithshme, dhe Zyrtari i Prokurimit				

Buxheti sipas kërkesës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2025 dhe sipas qarkores buxhetore 2025/1 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;

Kategoria	2024	2025	Diferenca 2024-2025	Kerkesa Buxhetore 2025	Difrenca Kerkesë - Buxhet 2025
Paga dhe Meditje	276,797	290,637	13,840	356,797	(66,160)
Mallra dhe shërbime	519,948	535,000	15,052	811,746	(276,746)
Shpenzime Komunale	16,500	16,500	-	20,700	(4,200)
Shpenzime Kapitale	50,000	-	(50,000)	72,930	(72,930)
Total Buxheti	863,245	842,137	(21,108)	1,262,173	(420,036)

6. Sfidat dhe rreziqet

Realizimi i këtij plani përmban sfida dhe rreziqe, ndër të cilat janë si në vijim:

- Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara për realizimin e të gjitha aktiviteteve në programet e trajnimit, si dhe mundësitë e kufizuara për zhvillim afatgjatë⁴;
- Hapësira dhe kushtet e pamjaftueshme për të përmbushë gjitha aktivitetet nga programet trajnuese⁵,
- Plotësim dhe ndryshimi i Ligjit për Akademinë e Drejtësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira;
- Staf i pamjaftueshëm për zbatimin e aktiviteteve hulumtuese dhe kërkimore;
- Procesi i rekrutimit për pozitat e lira sipas legjislacionit të ri në fuqi;
- Mirëmbajtja dhe përditësimi sistemeve të TI, avancimi i harduerit dhe softuerëve
- Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme individuale nga vlerësimi i performances;
- Zbatimi i doracakut për trajnues dhe funksionalizmi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;

7. Përfundimi

Plani i punës dhe i Performancës për vitin 2025 është përgatitur përshtatshëmrisht me mundësitë reale të Akademisë së Drejtësisë në përmbushjen e objektivave të përgjithshme. Zbatimi i planit të punës dhe performances në mase të madhe zbatohet nga stafi i AD, respektivisht nga struktura e re e brendshme organizative në përputhje me rregulloren e re për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të AD-së. Objektivat

⁴ Buxheti i limituar shtuar kësaj edhe shpenzimet për qiranë

⁵ Akademia e Drejtësisë vazhdon veprimtarinë e saj në objektin me qira për shkak të mos përfundimit të objektit sipas afateve të kontratës dhe funksionalizimit të tij.

e përgjithshme janë identifikuar dhe përmbledhur ne baze te zhvillimeve e reja, kërkesat e KGJK-së, KPK-së, gjykatave , Prokurorive, gjyqtareve , prokuroreve , stafit mbështetës, nevojave dhe prioriteteve te dala nga dokumentet strategjike dhe procesi euro-integrues, për nevojën e ngritjes dhe avancimin e profesionalizmit te sistemit te drejtësisë ne Kosove. Plani përmban në detaje aktivitetet trajnuese dhe aktivitetet tjera të përcaktuara me ligj duke përfshirë njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre. Stafi i Akademisë do të angazhohet në përmbushjen e këtij plani duke i marrë në konsideratë veprimet dhe afatet e përcaktuara për çdo aktivitetet të paraparë.